

**Prof. dr. Ferit DUKA**

## **LIDHJA E PRIZRENIT NË KONTEKSTIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-OSMANË**

### **Hyrje**

Edhe pse janë shënuar një varg arritjesh për sa i përket studimit të historisë së Lidhjes së Prizrenit, përsëri shihet e nevojshme që në rrafshin historiografik të kemi qasje më serioze e realiste kur është fjala për kthjellimin e mëtejshëm të vendit dhe të rolit të Lidhjes në marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe shtetit osman në rrjedhën e shek. XIX dhe sidomos gjatë ekzistencës së saj afro tre vjeçare. Ne shpresojmë se, në suazat e kësaj trajtese, përmes shqyrtimit dhe rishqyrtimit të të dhënave të përfutuara nga studimet e kryera si dhe nga burimet historike disponibël, të sillen ndriçime të mëtejme rreth argumentit të mësipërm.

### **Rilindja e çështjes shqiptare**

Është e ditur tashmë se pushtimi osman i tokave shqiptare dhe vendosja këtu e sundimit të shtetit të Gjysmë-Hënës, jo vetëm që ndryshoi rrënjësisht realitetet politike dhe ekonomiko-shoqërore në

këto hapësira, por shënoi edhe zanafillën e asaj që do të quhet "çështja shqiptare". Gjatë shekujve osmanë ajo u shpalos në edicione të ndryshme duke nisur nga epopeja e luftës çlirimtare të Skënderbeut, për të vijuar më pas me kryengritje të ndryshme, me orvatjet e pashallarëve të fuqishëm shqiptarë për të themeluar shtete të veçanta në vendin e tyre, etj. Në këtë kuptim, historia e periudhës osmane në tokat shqiptare paraqet një kontrast interesant midis përpjekjeve për të siguruar çdo përfitim të mundshëm që sjell qenia brenda një perandorie të madhe nga njëra anë, me luftërat e herëpashershme për liri që kanë zhvilluar shqiptarët kundër shtetit osman, nga ana tjetër. Megjithatë, është fakt i pamohueshëm se këto të fundit asnjëherë nuk janë errësuar nga "faqja e lumtur" e simbiozës shekullore midis dy palëve.

Në vitet 30-40 të shek. XIX Perandoria Osmane, e tronditur thellë nga konfliktet e brendshme si dhe nga vala e lëvizjeve çlirimtare të popujve ballkanikë, hyri në një proces reformimi të gjithanshëm të quajtur Tanzimat.<sup>1</sup>

Fillimin e erës reformiste e shënoi shpallja e bujshme e dekretit të Tanzimatit nga sulltan Abdylmexhiti I më 3 nëntor 1839. Në këtë dokument të rëndësishëm përcaktoheshin parimet kryesore të reformimit të shtetit osman, duke e vënë theksin në garantimin e lirisë dhe të sigurimit të jetës, nderit dhe pasurisë së shtetasve, vlerësimin e mbledhjen e rregullt të taksave duke eliminuar praktikën ekzistuese të sipërmarrjes së tyre (iltizamin), shërbimin e rregullt ushtarak, me kohë të përcaktuar dhe të barabartë për të gjithë shtetasit, si dhe në ngritjen e një sistemi gjyqësor të ri që do të sillte një gjykim publik të ndershëm dhe të bazuar në një legjislacion modern.<sup>2</sup> Nëpërmjet zbatimit të paketës së reformave, tanzimatistët synonin forcimin e pushtetit qendror osman nëpërmjet centralizimit të administratës, modernizimin e aparatit shtetëror, perëndimorizimin e shoqërisë

1 Osmanisht: rregullime, reforma.

2 Lord Kinross, *The Ottoman Centuries: the Rise and fall of the Turkish Empire*, Neë York: Morrow Quill Paperbacks, 1977, f. 474 .

osmane, si dhe laicizimin (megjithëse të ndrojtur) të së drejtës dhe arsimit.<sup>3</sup>

Një rëndësi themelore në zgjerimin e spektrit të reformave pati sidomos dekreti i dytë i Tanzimatit i publikuar në shkurt të vitit 1856. Nëpërmjet tij sovran i osman bënte të njohur vullnetin e vet për t'u garantuar me ligj të gjithë shtetasve të Perandorisë lirinë dhe barazinë (pavarësisht nga feja, etnia ose gjuha) në çështje të tilla si taksat, arsimi, drejtësia, pronësia, prania në administratën publike, në organet e zgjedhura administrative, etj. Në këto kushte, shqiptarët jomyslimanë fituan nga "Magna Carta" osmane e shek. XIX një varg të drejtash siç ishin aksesit në rangjet e ndryshme të administratës, çlirimi i popullsisë së krishterë nga taksa të tilla diskriminuese sikundër ishte xhizja, etj.<sup>4</sup>

Megjithatë, si komunitet kombëtar, shqiptarët nuk fituan asgjë nga reformat e sipërpërmendura, madje as të drejtën për të shkruar e mësuar në gjuhën e vet amtare. Jo vetëm kaq, por aspekte të tilla të reformave si, qendërzimi i skajshëm i shtetit osman, vendosja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, eliminimi i një vargu privilegjesh që gëzonte deri në atë kohë paria myslimane shqiptare në sferën ushtarake dhe atë fiskale, zëvendësimi i nëpunësve vendas me ata turq etj., nxitën reagime të ashpra kundërosmane në Shqipëri.<sup>5</sup>

Dekreti i dytë i Tanzimatit ishte në fakt një përtëritje në një nivel më të lartë i sistemit të Mileteve, sistem, në bazë të të cilit rregulloheshin marrëdhëniet midis shtetit osman si shtet islamik dhe bashkësive jomyslimane që jetonin nën çatinë e tij. Mirëpo, sidomos

3 Robert Mantran (ed.), *Historia e Perandorisë Osmane* (përkth. nga frëngjishtja prej Asti Papës), Tiranë, Dituria, 2004, f. 427.

4 Për këtë më gjerësisht shih: Lord Kinross, *Vep. e cit.*, f. 500; Robert Mantran (ed.), *Vep. e cit.*, f. 471

5 Stavro Skendi, *Zgjidhje kombëtar shqiptar, 1878-1912* (përkth. nga anglishtja prej S. Luarasit e N. Nepravi-shtës), Tiranë, PHOENIX-Shtëpia e Librit dhe Komunitetit, 2000, f. 31-32; *Historia e Popullit Shqiptar, Vëll. II* (bot. i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë), Tiranë, TOENA, 2002, f. 92-97.

duke filluar nga shek. XIX, filozofia e një sistemi të tillë vinte në kundërshtim të plotë me nevojat e bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm kombëtar. Duke qenë se sistemi në fjalë nuk bënte një dallim të qartë midis fesë dhe kombësisë, ose më mirë i jepte përparësi kriterit fetar dhe jo përkatësisë etnike për të identifikuar popullsi apo grupe të caktuara brenda tij, shteti osman vijonte ende të mos i njihte shqiptarët si entitet i veçantë kombëtar, por thjeshtë si rum milleti (popullsia ortodokse) e latin milleti (popullsia katolike), ndërsa popullsinë myslimane e quante pjesë të bashkësisë së përgjithshme islame të perandorisë (ummet-i İslam)<sup>6</sup>. Në këtë mënyrë, në një kohë që shqiptarëve u nevojitej më shumë se kurrë bashkimi për të realizuar aspiratat e tyre politike kombëtare, statusi me të cilin i njihte ata shteti osman në bazë të sistemit të lartpërmendur, thellonte ndarjen dhe largimin midis tyre dhe, rrjedhimisht, çonte në shpërbërjen e këtij komuniteti të veçantë etnik. Për më tej, duke u njohur një varg të drejtash komuniteteve të krishtera, synohej që ato të mbaheshin të lidhura me shtetin osman dhe jo që ato t'i shfrytëzonin këto të drejta për t'u shkëputur nga perandoria.<sup>7</sup>

Në klimën e përgjithshme politike të krijuar nga reformat osmane të cilat në rastin shqiptar kishin efekte kundërthënëse (ndërsa në njërin anë, kënaqnin deri në një farë mase interesa të caktuara të individëve apo grupeve të veçanta të shoqërisë, në anën tjetër, vinin në kundërshtim të plotë jo vetëm me interesa të individëve apo grupeve të tjera, por edhe me interesat e përgjithshme kombëtare), çështja shqiptare ridimensionohet në trajtën e një lëvizjeje të gjerë politike e kulturore kombëtare të njohur me emrin “Rilindje” dhe që kishte si synim përfundimtar çlirimin e Shqipërisë nga sundimi osman dhe krijimin e një shteti kombëtar të pavarur.<sup>8</sup>

6 Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane* (përkthyer nga turqishtja prej Dritan Egros), Tiranë, Dituria-Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2002, f. 143; Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar: II. Meşrutiyet Döneminde Arnavut Ulusçuluğu ve Arnavutluk Sorunu*, İstanbul: BUKE KITA-PLARI, 2004, f. 34

7 Nuray Bozborra, *Vep. e cit.*, f. 144-145.

8 Historiani gjerman, Peter Bartl, e quan të pajustificuar përdorimin e termit “Rilindje” së paku, në rastin e Shqipërisë, pasi sipas tij, nuk kishte çfarë të rilindte

Mbi këtë bazë lindi nacionalizmi shqiptar, i cili, ndryshe nga pohimi i bërë nga studiuesja Nuray Bozborra, sipas së cilës nacionalizmi në fjalë ka pasur natyrë konservatore, duke i lidhur gabimisht shkaqet e lindjes së tij vetëm me reagimet negative ndaj reformave modernizuese (nënkupto: Tanzimatit-F. D.)<sup>9</sup>, u zhvillua si një lëvizje me natyrë të qartë përparimtare dhe bashkëkohore, me një frymë të theksuar laike, e cila neutralizoi dallimet fetare e krahinore, duke nxjerrë në vijë të parë çështjen e identitetit kombëtar, si dhe duke forcuar e konsoliduar ndërgjegjen e bashkimit mbi baza kombëtare, në kundërshtim të hapur me ideologjinë panislamiste të shtetit osman.<sup>10</sup>

Udhëheqës të kësaj lëvizjeje u bënë intelektualët shqiptarë, një shtresë e arsimuar, shumë syresh me përvojë në administratën shtetërore osmane dhe njohës shumë të mirë të karakterit, traditave dhe kulturës së popullit të vet. Duke shfrytëzuar disa hapësira që krijoi Tanzimati për lirinë e mendimit dhe të organizimit, ata filluan të krijojnë shoqata kulturore, të cilat e dendësuan veprimtarinë e tyre në shërbim të gjuhës, historisë dhe kulturës shqiptare, duke përdorur një fjalor larg së qeni fetar.<sup>11</sup>

---

në shek. XIX te shqiptarët, kur, ndryshe nga popujt e tjerë ballkanikë, ata nuk kishin pasur një shtet të tyrin përpara se këtu të vinin osmanët! Një arsyetim i tillë nuk na duket i drejtë, sepse "Rilindja" si nocion, nuk mund të përdoret vetëm kur është fjala për rilindjen e një shteti, por edhe kur flitet për rilindjen e një epoke çlirimtare siç ishte epoka e Skënderbeut, evokimi i së cilës nga rilindësit shqiptarë, luajti një rol të pazëvendësueshëm në mobilizimin e bashkëkombësve të tyre për jetësimin e idealit kombëtar për çlirim nga sundimi osman dhe krijimin e shtetit shqiptar të pavarur. Shih: Peter Bartl, *Shqiptarët: nga Mesjeta deri në ditët tona* (sjellë në shqip nga gjermanishtja prej Afrim Koçit), Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit, (pa vit botimi), f. 101.

9 Nuray Bozborra, *Vep. e cit.*, f. 16.

10 Bilgin Çelik, *Vep. e cit.*, f. 32.

11 Nuray Bozborra, *Vep. e cit.*, f. 143.

Lufta e intelektualëve shqiptarë për emancipim kombëtar, jo vetëm që frymëzohej nga zhvillimet politike progresive në hapësirën ballkanike, si dhe rrymat ideologjike bashkëkohore të Evropës, por duket se merrte nxitje gjithashtu edhe nga lëvizja e liberalëve të parë osmanë të njohur me emrin “Osmanët e Rinj”. E përbashkëta e këtyre dy lëvizjeve ishte karakteri i tyre kundërabsolutist. Një paralelizëm i tillë në kohën e Abdylhamitit II do të kthehet në bashkëpunim midis shqiptarëve dhe Turqve të Rinj.<sup>12</sup>

Furia e ngjarjeve tronditëse të gjysmës së dytë të viteve 1870, siç ishin shpërthimi i kryengritjeve çlirimtare kundërosmane në Ballkan si dhe presioni sistematik i fuqive evropiane mbi Portën për reformim të sistemit politik të Perandorisë, e nxitën elitën reformatore osmane të udhëhequr nga kryeministri Mit’had Pasha që t’i impononte sulltanit kushtetutën e parë osmane (Kanun-i Esasi), e cila u publikua më 23 dhjetor 1876. Sipas ligjit të ri themelor, Shteti Osman shpallej monarki kushtetuese, me parlament dydhomësh dhe me një numër deputetësh të zgjedhur një në pesëdhjetëmijë shtetas osmanë (meshkuj). Kushtetuta shënonte një fitore të madhe të pjesës progresive të klasës politike osmane në vijim të përpjekjeve të saj për modernizimin e perandorisë. Ajo u garantonte të gjithë shtetasve, pa dallim, të drejta dhe detyrime të barabarta përpara ligjit.<sup>13</sup> Mirëpo edhe në këtë rast shqiptarët nuk njiheshin si komb më vehte, sepse ligji themelor i sipërpërmendur i quante “osmanë” të gjithë individët e perandorisë, pavarësisht nga përkatësia fetare apo kombëtare e tyre.<sup>14</sup>

Kësisoj, zhvillimet dramatike të Krizës Lindore i gjenin ende shqiptarët të shpërfillur si identitet i veçantë kombëtar nga shteti nën sundimin e të cilit ndodheshin prej shekujsh. Përballë një gjendjeje të

12 Nuray Bozbora, *Vep. e cit.*, f. 161; Më gjerësisht shih edhe: J. Swire, *Shqipëria: ngritja e një mbretërie* (përkth. nga anglishtja prej Kujtim Ymerit), Tiranë, Dituria, 2005, f. 53-56.

13 George Gawrych, *Vep. e cit.*, f. 5.

14 Po aty.

tillë kërcënuese, intelektualë të njohur shqiptarë me prirje atdhetare dhe vizion të kthjellët politik, u përpoqën ta ngrenë në një nivel më të lartë lëvizjen kombëtare shqiptare, duke e vënë atë mbi baza të shëndosha organizative. Sinjalet e para në këtë drejtim i dha Abdyl Frashëri, nëpunës në administratën e vilajetit të Janinës. Njeri tepër i zgjuar dhe i ditur, i guximshëm e i vendosur, me shpirt të theksuar sakrifice, bujar dhe fisnik nga natyra, ai u bë një nga figurat kryesore të shqiptarizmit të periudhës së Rilindjes.<sup>15</sup>

Në maj të vitit 1877 Abdyl Frashëri themeloi në Janinë një komitet shqiptar të përbërë nga përfaqësues të parisë së vilajetit me të njëjtin emër. Në një mbledhje të tij, Komiteti i Janinës deklaroi qartë se, në se Perandoria Osmane nuk do të mund t'i mbronte tokat e shqiptarëve, atëherë këta të fundit jo vetëm që do t'i mbronin vetë ato, por do të themelonin edhe një administratë autonome. Për më tej, Komiteti, në një memorandum dërguar Portës së Lartë, kërkonte bashkimin e vilajeteve shqiptare në një vilajet të vetëm, hapjen e shkollave shqipe dhe kryerjen e shërbimit ushtarak për shqiptarët brenda këtij vilajeti. Në emër të Komitetit të Janinës, Abdyl Frashëri hyri në bisedime edhe me përfaqësues të qeverisë greke, duke shtruar idenë e një kryengritjeje të përbashkët çlirimtare kundërosmane, por e braktisi këtë ide kur pa se pala greke nuk hiqte dorë nga projektet e saj për aneksimin e Shqipërisë së jugut.<sup>16</sup>

Përballë atmosferës së rënduar politike të krijuar në Ballkan si rezultat i marshimit triumfal të trupave ruse drejt Stambollit, si dhe ofensivës kundërosmane të shteteve ballkanike, u shtuan gjithnjë e më shumë reagimet publike të figurave kryesore të nacionalizmit shqiptar. Zëri i tyre për probleme të mprehta që po kalonte Shqipëria në kuadër

---

15 Në lidhje me jetën dhe veprën e këtij personaliteti të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe veçanërisht, të Lidhjes së Prizrenit, më gjerësisht shih: Sami Frashëri, *Vepra 2 (Personalitetet shqiptare në "Kamus al-alam")*, Shkup-Prishtinë, LogosA, 2004, f. 64-66; Kristo Frashëri, *Abdyl Frashëri (1839-1892)*, Tiranë, Shtëpia botuese "8 nëntori", 1984.

16 Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, Tiranë, Botimet TOENA, 1997, f. 44-47; *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II*, f. 139-142

të Perandorisë Osmane, filloi të jehojë gjithnjë e më fuqishëm deri në kryeqendrën e saj, Stamboll. Ishte përsëri Abdyl Frashëri, këtë herë deputet i Janinës, i cili në një seancë të Parlamentit të dytë Osman të çelur më 13 dhjetor 1877, mbajti një fjalim tronditës për çështjet e reformës arsimore. Frashëri theksoi shkallën e ulët të arsimit dhe paditurinë që sundonin në tokat shqiptare, duke kërkuar marrjen e masave të shpejta për daljen nga kjo gjendje e papranueshme. Pyetjes së "Cili ishte shkaku i prapambetjes së Shtetit Osman?", ai po vetë i përgjigjej duke vënë në dukje tri arsye: paditurinë, absolutizmin dhe rendjen pas dëfrimeve të nëpunësve të administratës. Edhe pse sipas tij, me shpalljen e Kushtetutës, absolutizmi kishte marrë fund, përsëri mbeteshin për t'u zgjidhur çështjet e nëpunësve dhe paditurisë. Duke iu referuar gjithnjë në këtë kontekst vendit të tij, Abdyl Beu, midis të tjerash, theksonte:

"...Në tokën shqiptare nuk ka asnjë fshat që të ketë shkollë dhe asnjë imam që të paktën të thërrasë një ezan nga e premtja në të premtje....Tashmë mjaft më! Si do të bëhemi ne të qytetëruar me këtë padituri? Si do të mund të përparojmë?"<sup>17</sup>

Traktati i Shën Stefanit i nënshkruar midis Ruisë fituese dhe Perandorisë Osmane humbëse të luftës, më 3 mars 1878, e rriti më tej tensionin dhe acarimin në mesin e shqiptarëve. Krahas me protestat popullore kundër planeve aneksioniste të shteteve fqinje, rrethet intelektuale dhe politike i shtuan përpjekjet për sensibilizimin e autoriteteve shtetërore osmane si dhe të kancelarive evropiane në dobi të çështjes shqiptare. Pashko Vasa, një tjetër figurë eminentë e nacionalizmit shqiptar, në mars të vitit 1878, i paraqiti ambasadorit britanik në Stamboll, Layard, shqetësimet e shqiptarëve për rreziqet që u kanoseshin për ekzistencën e tyre si komb. Bashkëbiseduesi shqiptar i shfaqti Layard-it shqetësimin se pjesë të rëndësishme të arealit shqiptar si Peja, Tetova, Dibra, Manastiri, etj., rrezikonin të binin nën sundimin e shteteve sllave.<sup>18</sup>

17 Selda Kılıç, "Bir Osmanlı Aydınının Arnavutluk'a Dair Görüş ve Düşünceleri", OTAM, 2006, Nr. 19, f. 259.

18 George Gawrych, *Vep. e cit.*, f. 66.

Abdyl Frashëri gjithashtu, në një artikull të botuar më 21 prill 1878 në gazetën turke "Basiret", jo vetëm që shpалosi konceptin e vet për krijimin e shtetit kombëtar me një shtrirje tokësore të barabartë me hapësirën etnike shqiptare, por i tërhiqte vëmendjen shtetit osman që të tregohet i vendosur për mbrojtjen e tokave shqiptare. Në lidhje me këtë çështje ai shkruante:

"Kufiri i vërtetë i Shqipërisë fillon në veri në Dalmaci, Malin e Zi, Bosnjë dhe Serbi, duke përfshirë Vrajën, Kyprlynë, Përlepin dhe Kosturin. Ndërsa në jugë nis nga Kosturi deri në zonën e Ambrakisë. Nuk ka rrugë tjetër veç krijimit të një Shqipërie të madhe e të fuqishme në një tokë ku jetojnë dy milion dhe që brenda këtyre kufinjve përfshihen edhe detet Adriatik dhe Jon.<sup>19</sup>

### **Problemi shqiptar dhe Shteti Osman gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit**

Zhvillimet shqetësuese të viteve 1877-1878 si në skenën ballkanike ashtu dhe në atë evropiane, i nxitën veprimtarët e lëvizjes nacionaliste shqiptare të themelojnë me shpejtësi një organizatë bashkuese dhe udhëheqëse gjithëkombëtare, e cila do të drejtonte luftën për mbrojtjen e vendit nga rreziku i aneksimit të huaj dhe do të parashtronte një program kombëtar për një status të ri politik të Shqipërisë. U krijua kështu më 10 qershor 1878 Lidhja e Prizrenit. Në të vërtetë, Lidhja shënonte kulmin e përpjekjeve për institucionalizimin në nivel kombëtar të bashkimit të shqiptarëve, duke pasur si pararendës në një proces të tillë Komitetin e Janinës, të përmendur më lart dhe sidomos, Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, të themeluar në Stamboll në dhjetor të vitit 1877 nga pjesëtarë të elitës politike dhe intelektuale shqiptare të asaj kohe.<sup>20</sup>

19 Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare...*, f. 68; *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II*, f. 152; Selda Kiliç, *Vep. e cit.*, f. 4.

20 Kryetar i këtij komiteti ishte Abdyl Frashëri, ndërsa si anëtarë të tij mund të

I drobitur tej mase nga vorbulla e ngjarjeve, sidomos, nga lufta shkatërruese me Rusinë, si dhe i shqetësuar nga humbjet e mundshme territoriale në Ballkan, shteti osman e përkrahu themelimin e Lidhjes, me shpresën se ajo do të funksiononte si një organizatë me karakter islamik, qëllim i vetëm i së cilës duhej të ishte mbrojtja e tokave shqiptare (osmane) nga pushtimi i huaj. Dhe nuk ka dyshim se në këtë pikë të rëndësishme (mbrojtja e tërësisë tokësore) interesat e shqiptarëve me ato të perandorisë konvergonin. Prandaj edhe vetë sovrani osman Abdylhamiti II, i kishte porositur autoritetet osmane me funksione në Dibër, Prizren, Gjakovë, etj., që të tregoheshin tolerantë ndaj nismave politike të intelektualëve shqiptarë.<sup>21</sup> Ndaj dhe autoritetet vendore osmane në Prizren në momentet fillestare të themelimit të Lidhjes nuk e kursyen mbështetjen si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë infrastrukturor deri në atë shkallë sa që Porta e Lartë, ndonjëherë u konsiderua gabimisht nga përfaqësuesit e huaj diplomatikë si krijuese dhe udhëheqëse e Lidhjes, pasi kjo e fundit, sipas tyre, i nevojitej Portës si “faktor i fuqishëm për arritjen e qëllimeve të saj të veçanta”<sup>22</sup>.

Megjithatë, jo rrallë, duke e shpërfillur këtë fakt, në letërsinë historiografike shqiptare marrëdhëniet midis Lidhjes së Prizrenit dhe shtetit osman janë vlerësuar fund e krye brenda një optike antagoniste ekstreme, pa dalluar asnjë moment apo fazë të përkimit të interesave të palëve dhe të pajtimit midis tyre për çështje të caktuara.<sup>23</sup>

---

përmenden: Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Ymer Prizreni, Zija Prishtina, Ahmet Koronica, Mihal Harito, Iljaz Dibra, Mihal Harito, Mehmet Ali Vrioni, Seid Toptani, Mustafa Nuri Vlora, Mane Tahiri, etj. Shih: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, f. 143.

21 Süleyman Külçe, *Osmanlı tarihinde Arnavutluk*, Izmir: 1944, f. 247.

22 *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: AIH), Vj.30-99, Nr. 84 (Raport i konsullit austro-hungarez Lippich për ministrin e Jashtëm Andrassy, Shkodër, më 1 shtator 1878)

23 Në punime me karakter analitik apo vepra sintetizuese, manifestimet dhe protestat e shqiptarëve kundër Traktatit të Shën Stefanit, themelimi i Lidhjes së Prizrenit si dhe lëvizjet për kundërshtimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, janë

Mirëpo shumë shpejt Lidhja e Prizrenit shfaqti një profil të qartë kombëtar duke treguar hapur se ishte themeluar për interesat shqiptare dhe jo ato osmane. Një gjë e tillë gjeti shprehje në ngjarjet e Gjakovës të gusht-shtatorit 1878, të cilat kulmuan me ekzekutimin e komisarit të lartë osman për dorëzimin e krahinave shqiptare të Plavës dhe Gucisë Malit të Zi, Mehmet Ali Pashës. Edhe pse është e qartë se ky funksionar i rëndësishëm u sakrifikua me pëlqimin e sulltanit për t'u treguar Fuqive të Mëdha se qëndresa e shqiptarëve ishte aq e fortë sa e pengonte perandorinë të zbatonte vendimet e Kongresit të Berlinit, ngjarja në vetvete ishte shumë domethënëse për sa i përket vendosmërisë së Lidhjes së Prizrenit për të mbrojtur tërësinë tokësore të Shqipërisë, pavarësisht nga luhatjet që mund të shfaqte shteti osman në vartësi të koniunkturës ndërkombëtare. Në një raport konsullor austro-hungarez vlerësohet se misioni i Mehmed Ali Pashës "sipas mendimit të Lidhjes dhe në kuptimin e programit të saj, ishte një tradhti ndaj popullit dhe vendit dhe të përbetuarve u shërbeu si duket si pretekst i dëshiruar që ta diskreditojnë atë plotësisht në opinionin e masave dhe aksionin e mëtejshëm kundër atij ta kthejnë në një çështje popullore"<sup>24</sup>.

Në një takim me konsullin britanik në Shkodër Kirby Green, udhëheqësit e Lidhjes së Prizrenit kishin theksuar karakterin dhe qëllimet e saj kombëtare, duke i deklaruar diplomatit në fjalë që kjo organizatë do t'i bënte të njohur botës se Shqipëria është tokë me trashëgimtarë dhe se sulltani nuk do të mund të nxirrte në treg asnjë pëllëmbë të saj pa marrë pëlqimin e trashëgimtarëve të saj legjitimë, shqiptarëve.<sup>25</sup>

---

konsideruar tërësisht si akte në kundërshtim me pëlqimin dhe vullnetin e Portës së Lartë. Shih midis të tjerash: K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare...*, f. 82-85; *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II*, f. 154-155.

24 AIH, Vj. 30-1-106, Nr. 87 (Relacion i konsullit Lippich për ministrin Andrassy, Shkodër, 14 shtator 1878).

25 Raport i konsullit Green për ministrin e jashtëm Salisbury, Shkodër, 11 nëntor 1878. Shih: Skënder Riza, *Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*

Fuqizimi i shpejtë i Lidhjes si organizatë politike gjithëkombëtare nëpërmjet aksioneve të guximshme për mbrojtjen e tokave shqiptare nga aneksimi i huaj, i dha asaj mundësinë që të shtronte pa humbur kohë edhe kërkesën për një status të ri politik të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Kjo bënte të domosdoshme që në radhë të parë, Shqipëria të identifikohet territorialisht gjë që presupozonte bashkimin e vilajeteve shqiptare në një vilajet të vetëm, të cilit shteti osman duhet t'i njihte të drejtën e një qeverisjeje autonome si fazë kalimtare drejt krijimit të shtetit shqiptar të pavarur në një koniunkturë ndërkombëtare më të përshtatshme në të ardhmen. S'ka dyshim se kjo ishte pika më e nxehtë dhe më delikate në marrëdhëniet e Lidhjes me Portën e Lartë. Kjo e fundit, ndërsa ishte shumë e interesuar që ta kishte Lidhjen dhe qëndresën e saj kundër pretendimeve territoriale të shteteve ballkanike si një alibi të fortë për të mos zbatuar vendimet e Kongresit të Berlinit për lëshimin e tokave të perandorisë shteteve në fjalë, ndjehej tmerrësisht e lënduar kur shqiptarët i kërkonin që të hynin në rrugën e mëvetësimit. Studiuesi S. Skendi me të drejtë ka vënë në dukje se lëvizja shqiptare ia kishte prishur qetësinë si sulltanit ashtu edhe kastës sunduese në Stamboll.<sup>26</sup>

Për herë të parë në trajtë të plotë e të institucionalizuar kërkesa e Lidhjes së Prizrenit për krijimin e një vilajeti të bashkuar shqiptar me qeverisje autonome u shtrua në një mbledhje të saj në Dibër në fillim të nëntorit 1878. Në këtë mbledhje merrnin pjesë përfaqësues të "Shoqërisë së Bashkimit të Dibrës" ("Debre Cemiyet-i Ittihadiye") dhe "Shoqërisë së Bashkimit të Toskërisë" (Toskalık Cemiyet-i Ittihadiye). Në emër të kësaj të fundit pikëpamjet i parashtrori Abdyl Frashëri. Fillimisht delegatët theksuan se brenda kufirit etnik dhe gjeografik të Shqipërisë përfshiheshin territoret që mbulonin administrativisht sanxhakët e Shkodrës, Novi Pazarit, Prishtinës, Prizrenit, Shkupit, Manastirit, Dibrës, Beratit, Gjirokastrës,

*dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit (1877-1885)*, Libri I, Prishtinë, Rilindja, 1996, f. 131.

<sup>26</sup> Stavro Skendi, *Vep. e cit.*, f. 96.

Prevezës dhe Janinës, me një popullsi të përgjithshme prej dy milion banorësh.<sup>27</sup> Me anën e një memorandumit të miratuar nga mbledhja e Dibrës kërkoheshin pesë reforma (islahat) për shqiptarët:

1. Krijimi i vilajetit të Shqipërisë, me kryeqytetin e tij me një vendndodhje qendrore në vilajet;

2. Emërimi i nëpunësve civilë që të dinin gjuhën e vendit;

3. Mësimi i shqipes në shkolla;

4. Krijimi i një asambleje të përgjithshme (meclis-i umumi) që do të mblidhej çdo vit për katër muaj dhe do të miratonte reformat e duhura për vendin;

5. Ndarja e të ardhurave të mjaftueshme për nevojat e zhvillimit të arsimit dhe të punëve publike.<sup>28</sup>

Sipas vlerësimeve të valiut të Kosovës, thelbi i memorandumit të Kuvendit të Dibrës ishte qeverisja autonome e shqiptarëve. Mirëpo funksionari i lartë osman, duke mos e fshehur skepticizmin ekstrem për mundësinë e vetëqeverisjes së shqiptarëve, të cilët ai i konsideronte si një komb me një popullsi të papërkulur, por që “u mungonte shumë qytetërimi dhe arsimit”, i sugjeronte Portës së Lartë që veprimet dhe kërkesat e tyre “të rrezikshme” të refuzoheshin në tërësi dhe Shqipëria (Arnavutluk) të vendosej nën një regjim ushtarako-policor.<sup>29</sup>

Mirëpo, sa më shpërfillës tregohej shteti osman ndaj kërkesave politike të shqiptarëve, aq më e vendosur tregohej Lidhja e Prizrenit jo vetëm në drejtim të afirmimit por edhe të realizimit të synimeve të saj. Kështu gjatë viteve 1879-1880 ajo i dëndëson përpjekjet për të mënjanuar administratën osmane në vilajetin e Kosovës duke i

27 George Gawrych, *Vep. e cit.*, f. 75-76.

28 Po aty, f. 76-77; Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane (1878-1881), shqipëruar, komentuar dhe përgatitur për botim nga Iljaz Rexha, Prishtinë, 1978, f. 48.

29 Po aty, f. 49-50; Noel Malcolm, *Kosova: një histori e shkurtër* (përkthyer nga anglishtja prej Abdullah Karjagdiut), Botim i dytë, Prishtinë-Tiranë, KOHA & Shtëpia e librit, 2001, f. 233-234.

marrë në duart e veta atributet e administrimit të këtyre viseve.<sup>30</sup> Në mbledhjen e Lidhjes të zhvilluar në Gjirokastrë më 23 korrik 1880 kërkesa për autonominë e Shqipërisë u paraqit në trajtën e saj më të avancuar, gjë që nënkuptonte krijimin e një shteti shqiptar autonom me lidhje vartësie shumë të dobëta me Stambollin.<sup>31</sup>

Të gjitha këto zhvillime shkaktuan alarm në kryeqendrën e perandorisë. Disa mbledhje të posaçme të Kabinetit osman i janë kushtuar problemit shqiptar. Është për t'u theksuar se po të shqyrtohen me kujdes procesverbalet e mbledhjeve të kabinetit osman, jo rrallë duken edhe qëndrime mirëkuptuese ndaj kërkesave të shqiptarëve.

Më refraktar ndaj këtyre çështjeve duhet të ishte sulltani dhe oborri i tij. Pas shpërndarjes përfundimtare të parlamentit në shkurt të vitit 1878, Abdylhamiti II kalon në sundim të plotë despotik. Duke qenë i shqetësuar për karakterin nacionalist të Lidhjes së Prizrenit, sulltan Abdylhamiti përpiqej që me anën e anëtarëve konservatorë të saj t'i jepte Lidhjes përmbajtje fetaro-islamike. Me këtë qëndrim sulltani nga njëra anë, donte ta shfrytëzonte këtë organizatë për qëndresë kundër shteteve që kërkonin tokat osmane (shqiptare), kurse nga ana tjetër, dobësonte frymën kombëtare të Lidhjes dhe eliminonte kështu rrezikun e shkëputjes së Shqipërisë nga perandoria.<sup>32</sup>

Nga ana tjetër, kërkesat e shqiptarëve për autonomi u pasqyruan negativisht nga ana e shtypit osman. Në numrin e saj të 5 dhjetorit 1878, gazeta "Tercümân-i Hakikat", të cilën e botonte në Stamboll Ahmet Mithad, kërkesat e shqiptarëve për autonomi i konsideronte si tradhti ndaj botës islame dhe me këtë rast shprehej habia se si Shqipëria e vogël me më pak se 1,5 milion banorë do të rezistonte kundër Ruisë, kur kjo e fundit kishte mundur vetë Perandorinë Osmane. E njëjta gazetë theksonte më tej se jo vetëm myslimanët,

30 Süleyman Külçe, *Vep. e cit.*, f. 251; *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, f. 188-192.

31 *Po aty*, f.198.

32 Më gjerësisht për këtë shih: Nuray Bozborra, *Vep. e cit.*, f. 175; George Gawrych, *Vep. e cit.*, f. 108.

por edhe shqiptarët e krishterë duhet të përfshiheshin në bashkësinë islame (d.m.th. të mbeteshin brenda perandorisë-F. D.)<sup>33</sup>.

Kundër shkrimit të sipërpërmendur reagoi në të njëjtën gazetë Sami Frashëri, i cili theksonte se shqiptarët nuk ishin tradhtarë që të kërkonin shkëputjen e tyre nga Shteti Osman, por kërkonin vetëm që ky i fundit të mbronte tokat e tyre nga pushtimi i huaj. Shtetet e huaja, theksonte më tej Sami Frashëri, po përdorin dy armë për copëtimin e Shqipërisë: forcën dhe arsimin. Gjëja më e mirë që mund të bëhej për neutralizimin e këtyre armëve do të ishte bashkimi i Shqipërisë në një vilajet të vetëm dhe kështu do të shmangeshin si rreziku i asimilimit kulturor, ashtu edhe ai i përdorimit të forcës ushtarake nga ana e tyre.<sup>34</sup>

Më 6 qershor 1880 Porta e Lartë vendosi që administrimi i vilajeteve që ndodheshin në territorin shqiptar të bëhej në kuadër të një vilajeti të vetëm, të quajtur "vilajeti i Rumelisë", si dhe emërimin e Ahmed Ejup Pashës si vali i këtij vilajeti. Me këtë llogaritej që, me bashkimin e administratës qeveritare të territoreve shqiptare, njëkohësisht përmbushej edhe dëshira e shqiptarëve, dhe se një veprim i këtillë do të shërbente si arsye e fortë për qetësimin e kryengritjes si dhe të çrregullimeve në Shqipëri.<sup>35</sup> Megjithatë kjo tani ishte larg standardit të kërkuar nga Lidhja e Prizrenit, e cila tashmë e kishte bërë të qartë aspiratën për një shtet autonom shqiptar.

Përkundër vullnetit të qarqeve drejtuese të Perandorisë Osmane, Lidhja e Prizrenit, në janar të vitit 1881 kaloi në realizimin konkret të idesë së shtetit autonom shqiptar duke shpallur krijimin e Qeverisë së Përkohshme, e cila me shpejtësi filloi aksionin për vendosjen e kontrollit të saj në tokat shqiptare.<sup>36</sup> Njeriu më energjik për triumfin e çështjes shqiptare, Abdyl Frashëri, në fjalimin e mbajtur në një miting të madh të organizuar në Prizren aty nga mezi

33 Nuray Bozborra, *Vep. e cit.*, f. 175.

34 *Po aty*

35 *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*, f. 67-68.

36 Më gjerësisht për këtë shih: Stavro Skendi, *Vep. e cit.*, f. 97-101; *Historia e popullit shqiptar*, f. 216-220.

i shkurtit 1881, kërkoi që Lidhja Shqiptare të bënte përpjekje të mëtejme për të siguruar tashmë pavarësimin e plotë të Shqipërisë duke bashkuar të gjithë shqiptarët rreth kauzës së përbashkët.<sup>37</sup> Aq serioze ishte kjo organizatë në kryerjen e misionit të saj, sa që kishte siguruar edhe simbole kombëtare siç ishin flamujt shqiptarë.<sup>38</sup> Mirëpo Qeveria e Përkohshme shënoi njëkohësisht edhe kulmin edhe fundin e veprimtarisë së Lidhjes së Prizrenit.

Në Stamboll merret vendimi për likuidimin e saj dhe paqësimin përfundimtar të Shqipërisë. Ekzekutimi i këtij vendimi iu besua një gjenerali të egër e mizor siç ishte Dervish Pasha. Nënshkrimin e tij e mbajnë si dorëzimi i qytetit të Ulqinit Malit të Zi, ashtu edhe shtypja e Lidhjes së Prizrenit shoqëruar me një valë ndjekjesh, persekutimesh e asgjësimesh të udhëheqësve dhe veprimtarëve të saj.

37 Noel Malcolm, *Vep. e cit.*, f. 235.

38 *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*, f. 113.

Prof. dr. Ferit DUKA

## SUMMARY

### THE LEAGUE OF PRIZREN IN THE CONTEXT OF THE ALBANIAN - OTTOMAN RELATIONS

In the overall political climate, the Albanian cause gained a re-dimensioned form of a broad political and national cultural movement known as "the renaissance" aiming the final liberation of Albania, and creation of an independent state. On this basis, Albanian nationalism was born.

The war of national liberation Albanian intellectuals inspired by contemporary ideological currents in Europe and also fostered by the liberals movement of "Young Ottomans." Common to these two movements was their anti-absolutist nature. On June 10, 1878 was formed the League of Prizren. It marked the peak in efforts to institutionalize the national unification of Albanians. The Ottoman state supported the establishment of the League, hoping it would function as a organization of Islamic character.

The request of the League of Prizren to create a united Albanian Vilayet with autonomous government was submitted at a meeting in Dibra in begining of November 1878. At this meeting attended by representatives of "Dibra Union Association" ("Debre Cemiyet-i Ittihadiye") and "Toskëria Union Association" (Toskalık Cemiyet-i Ittihadiye).

Being concerned about the nationalistic character of the League of Prizren, Sultan Abdulhamit tried through conservative members to attribute the League with the Islamic character.

On June 6, 1880, the Grande Porte decided to administer the vilayets in the Albanian territories as a unified single Vilayet, called "Vilayet of Rumelia", and appointed Ejup Ahmed Pasha for the vali of Rumelia. The Porte calculated that unification of Albanian territories under a single governmental administration would simultaneously fulfill the will of the Albanians. Yet, it was too late and far of the demands and standards of the Prizren League, which already had openly proclaimed the aspirations for an autonomous Albanian state. The League of Prizren, in January 1881, moved forward with the realization of its idea for an autonomous Albanian state by announcing the creation of the Provisional Government, which rapidly began action to establish its control in the Albanian lands.

Istanbul made the decision to liquidate the League. The execution of this decision was entrusted to general Dervish Pasha, renowned for his brutality and cruelty. The submission of the town of Ulqin to Montenegro and oppression of the League of Prizren hold his stamp, associated by a wave pursuit, persecution and liquidation of its leaders and activists.